EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5533
E hënë, 23 korrik 2018
çmimi 0.40 €

## Ekrem Bardha, shqiptaro-amerikani që loboi aq shumë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës

FAQE 12-13



Shkruan:
Ferdinand SAMARXHI,
*Fitues i Antenës së Artë*
*Mjeshtër i Madh*

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA FAQE 4-5

# Duhet unitet politik për dialogun



Njohësi i rrethanave politike në vend, Behxhet Shala, ka thënë se është çati vendimtar që të gjitha partitë politike të bëhen bashkë dhe të arrijnë konsensus për ta parandaluar çdo rrezik të mundshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se faktori politik në Kosovë duhet të ketë unitet për procesin e dialogut me Serbinë. Shala ka theksuar se nëse nuk arrihet ky unitet, të gjithë do ta paguajnë çmimin. Sipas tij, askush nuk mund t'i ikë përgjegjësisë nga ky proces. Shala ka hedhur poshtë mundësinë që pjesë e bisedimeve të jetë edhe çështja e territoreve, duke thënë se nëse kufijtë vihen në lojë, atëherë lufta është e pashmangshme. Ai ka vlerësuar se loja e territoreve është një kërcënim në mënyrë që të pranohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe

## Kërkohet vëmendje institucionale për sigurimin shëndetësor për policinë




Janë rreth 8 000 pjesëtarë me uniformë të Policisë së Kosovës të cilët nuk kanë ende sigurim shëndetësor dhe jetësor. Zëvendëskryetarja e Sindikatës së Policisë së Kosovës, Valbona Kamberi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kërkesa për sigurime shëndetësore ka hasur në vesh të shurdhër nga institucionet. Duke marrë parasysh rrezikshmërinë e punës së policëve, drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku, ka apeluar që sa më shpejt të gjenden alternativa për këtë çështje FAQE 8

## Limaj parasheh që deri në shtator të ndërtohet grupi i unitetit për dialog



### AKTUALE

**KOSOVA DHE SERBIA, TË 'SHTRËNGUARA' TA PËRMBYLLIN DEMARKACIONIN E KUFIRIT** F. 7

**MPJ: SERBIA PO SHET E FAL ARMË PËR TA PENGUAR NJOHJEN E KOSOVËS** F. 6

**ALARMON POLICIA: GJENDJA E SIGURISË NË RRUGË, SHQETËSUESE** F. 6

### EKONOMI



**NË IOWA PROMOVOHEN MUNDËSITË PËR INVESTIME NË KOSOVË** F. 9

**KOMUNA E PRISHTINËS PËR GJASHTË MUAJ REALIZON 12 MILIONË EURO TË HYRA** F. 9

### SPORT

**HISTORIA INTERESANTE E BARDH KELMENDIT NË SPORT** F. 18

**PAPUQI: E DUA EVROPËN ME GJILANIN** F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Ministri gjerman për Evropën vjen në Tiranë



TIRANË, 22 KORRIK - Ministri për Çështjet Evropiane në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, Michael Roth, do ta vizitojë Tiranën, i cili, sipas agjendës së planifikuar, do të zhvillojë takime të nivelit të lartë në kuadër të temës së nxehtë, siç është ajo e negociatave të anëtarësimit. Roth do ta takojë kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Jashtëm Ditmir Bushati. Më pas do të ndalet në një takim me drejtues të Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor për Ballkanin Perëndimor, por edhe me opozitën dhe shoqërinë civile. "Sapo mbërrita në Tiranë. Do të takohem me kryeministrin Rama, ministrin Bushati, me drejtues të RYCO-s, opozitën dhe shoqërinë civile. Dua ta falënderoj veçanërisht mikun tim Ditmir Bushati që një ditë si kjo, në vend se të kalojë kohë me familjen, na organizoi takimin e sotëm", ka njoftuar Roth në Tëitter.
Kujtojmë se kjo është e disata vizitë e Rothit në Shqipëri, teksa Gjermania është një nga promotoret më të mëdha të vendit tonë në BE dhe lobuesja më e konsoliduar që e kërkon avancimin e Shqipërisë në një stad të ri siç është nisja e bisedimeve të anëtarësimit, pavarësisht skepticizmit në disa vende të bllokut.

# Amnesty International: Serbia ta ndalë menjëherë shitjen e armëve

**Pas një video të ekzekutimeve në Kamerun që paraqiste ushtarë duke përdorur armë të prodhuara nga Serbia, Amnesty International i kërkoi Serbisë ta ndalonte eksportimin e armëve në vend**



PRISHTINË, 22 KORRIK - Serbia ka shitur 425 armë të quajtura "Coyota" dhe "Zastava M21", në Kamerun ndërmjet viteve 2014 dhe 2016, armë këto të cilat janë blerë për të për ta luftuar Boko Haramin. Pas një video të ekzekutimeve në Kamerun që paraqiste ushtarë duke përdorur armë të prodhuara nga Serbia, Amnesty International i kërkoi Serbisë ta ndalonte eksportimin e armëve në vend.
Amnesty International tha për BIRN (Balkan Investigative Reporting Network) se Kameruni ka përdorur armët serbe në një model të "shkeljeve sistematike" të të drejtave të njeriut dhe i ka bërë thirrje Serbisë ta pezullojë eksportin e armëve në shtetin afrikan.
"Duke pasur parasysh dëshminë e besueshme të armëve 'Zastava M21' që përdoreshin nga ushtarët e Kamerunit për t'i kryer ekzekutimet e tmerrshme jashtëgjyqësore të dy grave dhe dy fëmijëve të vegjël, Serbia - një furnizuese kryesore e armëve të vogla në Kamerun, duhet t'i pezullojë furnizimet e mëtejshme", tha Patrick Wilcken, hulumtues i kontrollit të armëve në Amnesty International. "Kjo nuk është hera e parë që Amnesty International ka dokumentuar abuzimet e të drejtave të njeriut nga forcat kamerunike duke përdorur armët e vogla serbe. Përkundrazi, ajo pasqyron një model të shkeljeve sistematike", shtoi Wilcken.
Komenti erdhi pasi Amnesty dhe Bellingcat deklaruan se kishin vërtetuar se arma e parë në videon e ekzekutimit të grave dhe fëmijëve, të akuzuar për përkatësi të grupit të jashtëligjshëm islamik Boko Haram, ishte një "Zastava M21" e prodhuar nga Serbia.
Arma prodhohet në Fabrikën shtetërore të armëve "Zastava" në Kragujevc.
Ministria e Tregtisë e Serbisë, e cila lëshon leje për eksport të armëve dhe Ministria e Mbrojtjes, nuk iu përgjigjën pyetjeve të BIRN-it për shitjen e armëve në Kamerun deri në kohën e publikimit. Sipas të dhënave nga Traktati i OKB-së për Tregtinë e Armëve, Kameruni ka qenë një nga përfituesit më të mëdhenj të armëve serbe që nga viti 2013.
BIRN raportoi në shtator të vitit të kaluar se në disa postime në "Twitter", kishin kapur imazhet e mitralozave serbë "Coyote", në Kamerun dhe Nigeri, kapur, me sa duket, nga luftëtarët e Boko Haram.
Më 12 korrik Amnesty raportoi se një hetim kishte "mbledhur dëshmi të besueshme se ishin ushtarët e Kamerunit të përshkruar në një video që kryenin ekzekutimet e tmerrshme jashtëgjyqësore të dy grave dhe dy fëmijëve të vegjël".
Issa Tchiroma Bakary, ministri kamerunas i Komunikimit, e hodhi poshtë këtë video si lajm të rremë, por tha se autoritetet do të zhvillonin një hetim. "Megjithëse kemi treguar se kjo është e rreme, kreu i shtetit ka udhëzuar Ministrinë e Mbrojtjes të hapë një hetim tërësor në të cilin asnjë gur nuk duhet të lihet i palëvizur", citohet të ketë thënë Bakari.
Amnesty, megjithatë, deklaroi se "të dyja armët dhe uniformat e ushtarëve në video janë tregues të Ushtrisë së Kamerunit dhe modelet e ekranit përputhen me një numër njësish të mundshme, duke përfshirë këmbësorinë e rregullt dhe Batalionin e Intervenimit të Shpejtë (BIR) nga forcat e ushtrisë së Kamerunit".
Paul Biya, i cili ka qenë president i Kamerunit për 36 vjet, po përballet me akuza për abuzime brutale të të drejtave të njeriut.
Më 13 korrik "Associated Press" raportoi se Biya është një nga udhëheqësit më të gjatë në shërbim të Afrikës dhe se ai mbikëqyr një vend afrikan që po përballet me një lëvizje ndarëse anglofone dhe kërcënimin nga ekstremistët e Boko Haramit që kalojnë kufirin nga Nigeria.

## Rama për refugjatët: Nuk i shmangemi përgjegjësisë



TIRANË, 22 KORRIK - Evropa po kalon një periudhë të vështirë që prej 2015-s ku miliona refugjatë nga vendet e lindjes dhe zonat e luftës u dyndën në portat e Bashkimit Evropian. Kryeministri Edi Rama thekson se në këtë situatë Shqipëria, pavarësisht se nuk është ende pjesë e Unionit, është e gatshme ta bëjë pjesën e saj lidhur me krizën e refugjatëve.
"Ne nuk do të jemi asnjëherë pjesë e ndonjë plani ku refugjatët do të trajtohen si njerëz të infektuar. Nga ana tjetër, ne jemi të gatshëm ta bëjmë pjesën tonë. Nuk mendoj se Evropa është vetëm për t'i ndarë përfitimet nga buxheti, por Evropa është për t'i ndarë edhe përgjegjësitë. Ne nuk jemi në Bashkimin Evropian, por duhet dhe të jemi të gatshëm ta marrim pjesën tonë, as më shumë dhe as më pak. Ky është nocioni ynë. Shqipëria është vendi ku njerëzit në rrezik gjithmonë gjejnë strehë. Ne jemi i vetmi vend në Evropë ku hebrenjtë ishin më të shumtë në numër pas luftës sesa përpara luftës. Asnjë hebre nuk iu dorëzua nazistëve në Shqipëri. Më vonë kemi pasur më shumë se gjysmë milioni refugjatë nga Kosova. Ne jemi një vend i vogël për gjysmë milioni refugjatë, por ia dolëm më së miri. Në ditët e sotme ne kemi mirëpritur disa mijëra refugjatë nga Irani, refugjatë politikë. Pra, ne jemi një vend që ofrojmë strehë. Ne jemi një vend që përfiton nga mikpritja në Gjermani, në Itali dhe Greqi, në Evropë dhe Amerikë. Pra, shqiptarët asnjëherë nuk i kanë konsideruar si refugjatët në rrezik, apo si diçka që duhet shmangur", ka thënë Rama.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Tetë vjet më parë Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) dha mendimin këshillues mbi legalitetin e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës

# Vendimi i GjND-së, ndër fitoret më të mëdha ndërkombëtare

Kosova ka kujtuar të dielën tetëvjetorin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) mbi legalitetin e pavarësisë së Kosovës. Përfaqësuesit e institucioneve kanë theksuar se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) mbi legalitetin e pavarësisë së Kosovës i siguroi Kosovës ndër fitoret më të mëdha ndërkombëtare

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të dielën se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) mbi legalitetin e pavarësisë së Kosovës i siguroi Kosovës ndër fitoret më të mëdha ndërkombëtare. "Ky vendim u parapriu shumë proceseve politike, në të cilat ishim të bashkuar, duke ia siguruar Kosovës ndër fitoret më të mëdha ndërkombëtare. Edhe sot na presin shumë sfida, e për tejkalimin e tyre duhet të japim kontribut të gjithë, për t'i siguruar fitoret e radhës së shtetit tonë, anëtarësimet në BE, NATO dhe OKB", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se tetë vjet më parë Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i dha legalitet të drejtës sonë për shtet. "GjND-ja, në opinionin e vet, vlerësoi se përpjekjet tona historike ishin të drejta. Ky vendim i rëndësishëm hapi rrugë për ta ndërtuar Kosovën shtet modern që aspiron integrimet euroatlantike. Ne kemi ende punë për të bërë, por progresi nuk do të ndalet. Me dhënien e dritës së gjelbër për liberalizim të vizave vuloset e ardhmja jonë në familjen e shteteve paqedashëse dhe demokratike. Kosova në tërësinë e saj të plotë territoriale është faktor i rëndësishëm i stabilitetit në rajon dhe më gjerë", ka shkruar Haradinaj.

Ndërkaq lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në tetëvjetorin e verdiktit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që konfirmonte ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës ka kritikuar presidentin Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj, duke thënë se ata po vrapojnë pas presidentit të Serbisë. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", Kurti ka thënë se Qeveria Thaçi e asaj kohe, e më vonë qeveria pasardhëse e deri te kjo Haradinaj, e kanë harruar pikërisht këtë moment përurues me potencial emancipues të Deklaratës së Pavarësisë. "Kush ka mundur ta paramendojë që tetë vjet pas vendimit të GjND-së mbi ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, e i cili goditi rëndë Serbinë ndërkombëtarisht, do të kemi president që flet për kompromise të reja të dhimbshme ndaj Serbisë? Kush ka mundur ta paramendojë që tetë vjet pas atij të vendimi të GjND-së, do të kemi president e Qeveri që vrapojnë pas presidentit të Serbisë, e që kërkojnë pajtim me Serbinë e papenduar dhe pa e paditur atë për krimet e luftës e për gjenocid?", ka shkruar Kurti. Ai ka theksuar se leximi që GjND-ja i bëri Deklaratës së Pavarësisë doli të jetë më përparimtar sesa qëndrimet e veprimet e qeveritarëve të Kosovës të udhëhequr nga Hashim Thaçi. "E, regresioni i këtij po vazhdon me shpejtësinë e njëjtë të vrapimit që ai bën pas Serbisë e Vuçiqit", ka thënë Kurti. Por lideri i LV-së ka pyetur se çfarë ka ndodhur më pas? "Qeveria Thaçi e asaj kohe, e më vonë qeveria pasardhëse e deri te kjo Haradinaj, e kanë harruar pikërisht këtë moment përurues me potencial emancipues të Deklaratës së Pavarësisë. Duke pranuar bisedime të vazhdueshme me Serbinë për çështje të brendshme të Kosovës, të ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian, kanë pranuar të ulen në tryezë bisedimesh me dy entitete (Serbia në njërën anë, BE-ja në anën tjetër) të cilat ose janë armiqësisht kundër vetë qëllimit themelor të asaj shpalljeje (rasti i Serbisë) ose janë neutralë karshi të njëjtës (rasti i BE-së)", ka deklaruar Kurti.



## Pritje të gjata në pikat kufitare të Kosovës



Prishtinë, 22 korrik - Në pikat kufitare të Kosovës, gjatë sezonit të verës, vazhdojnë pritjet e gjata të qytetarëve që jetojnë jashtë vendit dhe vijnë në Kosovë, si dhe të atyre që dalin nga Kosova. Në Qendrën Kombëtare për Menaxhim Kufitar pritjet më të gjata raportohen në kufirin e Hanit të Elezit (100 metra), në kufirin e Merdares (500 metra), si dhe në kufirin e Mutivodës (50-70 metra). Pavarësisht prej deklarimeve të autoriteteve për shtim të kapaciteteve në kufij, pritjet e gjata janë shpesh të paevitueshme.

Në zbatim të pikave të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës të datës 6 korrik, e aplikueshme për periudhën 15 korrik deri më 15 shtator, Dogana e Kosovës me anë të një komunikate për media ka udhëzuar të gjithë stafin operativ që operon në kuadër të pikëkalimeve, që me rastin e kryerjes së detyrave të punës, ushtrimin e mandatit tyre të përcaktuar me ligj ta bëjnë në frymën e Rezolutës së Kuvendit të së Kosovës.

Në lidhje me këtë secili zyrtar doganor duhet të përkujdeset që i gjithë procesi i punës të zhvillohet shpejt duke treguar azhuritet për kryerjen e procedurave të rregullta kufitare; të gjithë personat që qarkullojnë përmes PKK-së, në veçanti bashkatdhetarët tanë, të trajtohen në mënyrë profesionale; udhëheqësit e PKK-së duhet të përkujdesen që përmes menaxhimit me efiçiencë të rrezikut t'i shkurtojnë procedurat e përditshme të kontrollit; rastet kur bashkatdhetarët bartin me vete mallra, të vlerësohen shpejt dhe në drejt. Në rastet e veçanta dhe sipas diskrecionit ligjor të merret vendim lidhur me trajtimin e tyre pa shkaktuar situata të cilat pengojnë qarkullimin dhe lehtësimin e lëvizjes së mallrave dhe udhëtarëve.

Flet për "Epokën e re", Behxhet Shala

# Duhet unitet politik



Njohësi i rrethanave politike në vend, Behxhet Shala, ka thënë se është çati vendimtar që të gjitha partitë politike të bëhen bashkë dhe të arrijnë konsensus për ta parandaluar çdo rrezik të mundshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se faktori politik në Kosovë duhet të ketë unitet për procesin e dialogut me Serbinë. Shala ka theksuar se nëse nuk arrihet ky unitet, të gjithë do ta paguajnë çmimin. Sipas tij, askush nuk mund t'i ikë përgjegjësisë nga ky proces. Shala ka hedhur poshtë mundësinë që pjesë e bisedimeve të jetë edhe çështja e territoreve, duke thënë se nëse kufijtë vihen në lojë, atëherë lufta është e pashmangshme. Ai ka vlerësuar se loja e territoreve është një kërcënim në mënyrë që të pranohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 KORRIK - Analisti politik Behxhet Shala ka thënë të dielën se tashmë është arritur marrëveshja midisi Thaçit e Vuçiqit dhe se vetëm po kërkohet një mënyrë për t'u plasuar në opinion. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se kjo marrëveshje do të jetë e dhimbshme për të dyja palët. "Mendoj se tashmë veç është arritur një marrëveshje midis Thaçit dhe Vuçiqit dhe se vetëm po kërkohet një mënyrë për t'u plasuar në opinion. Siç e dini, këtu më nuk po flitet për vite, por për muaj dhe për një marrëveshje të dhimbshme për të dyja palët", është shprehur Shala, duke shtuar se faktori politik në Kosovë duhet të ketë unitet për procesin e dialogut me Serbinë. Në këtë kontekst ai ka bërë me dije se është momenti vendimtar që të gjitha partitë politike të bëhen bashkë dhe të arrijnë konsensus për të parandaluar çdo rrezik të mundshëm. "Nëse nuk arrihet ky unitet, të gjithë do ta paguajnë çmimin. Askush nuk mund të thotë se e kemi kundërshtuar Thaçin dhe me këtë e kemi kryer detyrën tonë politike e kombëtare. Nëse i ikën procesit dhe nuk je pjesë e tij, nuk mund t'i ikë përgjegjësisë. Debatet e deritashme kanë qenë të kota. Faktori politik shqiptar duhet të vetëdijesohet se është momenti i fundit që t'i parandalojë disa zhvillime negative. Për këtë arsye duhet uniteti politik duke u larguar prej disa parimeve të përcaktuara", ka deklaruar Shala. Ai ka hedhur poshtë mundësinë që pjesë e bisedimeve të jetë edhe çështja e territoreve, duke thënë se nëse kufijtë vihen në lojë, atëherë lufta është e pashmangshme. Shala ka vlerësuar se loja e territoreve është një kërcënim në mënyrë që të pranohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. "Nuk shoh rrezik për territore, sepse nëse kufijtë vihen në lojë atëherë lufta është e pashmangshme. Mendoj se është momenti vendimtar që të gjitha partitë politike të bëhen bashkë dhe të arrijnë një konsensus që të parandalojnë çdo rrezik të mundshëm. Ndonëse jam i sigurt se një marrëveshje preliminare është arritur, tani vetëm po kërkohet mënyra se si të plasohet kjo marrëveshje para opinionit, sidomos atij në Kosovë, pa shkaktuar turbulencë të madhe", ka theksuar Shala.

**"Epoka e re":** *Z. Shala, si po e shihni përmbylljen e procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë?*

**Shala:** Mendoj se tashmë veç është arritur një marrëveshje midisi Thaçit dhe Vuçiqit dhe se vetëm po kërkohet një mënyrë për t'u plasuar në opinion. Siç e dini, këtu më nuk po flitet për vite, por për muaj dhe për një marrëveshje të dhimbshme për të dyja palët.

**"Epoka e re":** *Çfarë do të thotë kjo marrëveshje e dhimbshme për të dyja palët?*

**Shala:** Janë hedhur në ajër tema të mëdha, madje po flitet edhe për territore, në mënyrë që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe të kalojë më lehtë dhe të ketë kompetenca ekzekutive. Këtu është krejt qëllimi. Nuk besoj se çështja e territoreve do të jetë pjesë e këtij dialogu sepse po të flitet për territore duhet të flitet për të gjitha territoret ku kanë jetuar

# për dialogun



më herët shqiptarët. Nuk shoh mundësi të këtë ndryshim kufijsh. Askujt nuk i përshtatet ndryshimi i kufijve sepse do të ketë pasoja për të gjitha shtetet përreth. Askush nuk ka kohë t'i ndryshojë kufijtë e shteteve ballkanike meqë nuk e dinë se ku do të përfundojë. Mirëpo qëllimi është të krijohet një etnitet i Serbisë përmes serbëve të instrumentalizuar i cili në të ardhmen do të ishte shumë i dëmshëm për Kosovën. Loja e territoreve është një kërcënim në mënyrë që të pranohet Asociacioni.

**"Epoka e re":** *Nuk shihni rrezik që çështja e territoreve të jetë pjesë e tavolinës së bisedimeve?*
**Shala:** Jo, sepse nuk mund të flitet vetëm për territorin e një shteti, por duhet të flitet për të gjitha territoret ku kanë jetuar shqiptarët. Në rrethanat aktuale dikush duhet të jetë i çmendur që të pranojë që Serbisë t'i japë territor, aq më parë që ajo ka marrë shumë më tepër sesa që i ka takuar. Nuk shoh rrezik për territore, sepse nëse kufijtë vihen në lojë, atëherë lufta është e pashmangshme. Mendoj se është momenti vendimtar që të gjitha partitë politike të bëhen bashkë dhe të arrijnë një konsensus që ta parandalojnë çdo rrezik të mundshëm. Ndonëse jam i sigurt se një marrëveshje preliminare është arritur. Dhe tani vetëm po kërkohet mënyra se si të plasohet kjo marrëveshje para opinionit sidomos atij në Kosovë pa shkaktuar turbulencë të madhe.

**"Epoka e re":** *Si mund të arrihet konsensusi kur tashmë edhe LDK-ja po e kundërshton vazhdimin e procesit të dialogut?*
**Shala:** LDK-ja po e luan një lojë të pandershme. Është pikërisht LDK-ja që e ka votuar Thaçin për president. LDK-ja ka vrapuar maratonën, kurse në kilometrin e 44 po mundohet të tërhiqet. Por mendoj se LDK-ja duhet të bëhet pjesë e procesit. Unë e kundërshtoj Hashim Thaçin për kryenegociator sepse ai duhet të jetë i barabartë me të tjerët, pra i jap përparësi Qeverisë dhe Kuvendit. E përkrah Thaçin vetëm nëse ai del para Kuvendit dhe e merr bekimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Për këtë arsye duhet të arrihet një konsensus politik paraprak që të shikohet se cilat kanë qenë dobitë dhe dëmet e këtij procesi, dhe si duhet të shkohet më tutje. Evropa dhe partnerët ndërkombëtarë të pranojnë vetëm nëse ti ke kapacitet destabilizues, sepse ai që ka kapacitet destabilizues ka kapacitet edhe stabilizues. Hashim Thaçi duhet të ulet dhe ta dijë se është vetëm i pari në mesin e të barabartëve.

**"Epoka e re":** *Jeni optimist se do të mund të arrihet ky unitet politik?*
**Shala:** Nëse nuk arrihet ky unitet, të gjithë do ta paguajnë çmimin. Askush nuk mund të thotë se e kemi kundërshtuar Thaçin dhe me këtë e kemi kryer detyrën tonë politike e kombëtare. Nëse i ikën procesit dhe nuk je pjesë e tij nuk mund t'i ikë përgjegjësisë. Debatet e deritashme kanë qenë të kota. Faktori politik shqiptar duhet të vetëdijesohet, se është çasti i fundit që t'i parandalojë disa zhvillime negative. Për këtë arsye duhet uniteti politik duke u larguar prej disa parimeve të përcaktuara.

**"Epoka e re":** *Në vend të arritjes së unitetit, opozita po kërkon zgjedhje të reja.*
**Shala:** Mund të kërkojë çfarë të dojë, por zgjedhje nuk do të ketë. Në rrethanat normale faktori ndërkombëtar kurrë nuk do të pranonte që Kosova të udhëhiqet nga Thaçi, Veseli e Haradinaj, mirëpo këta u duhen për vendime me muskujt të cilët edhe mund të jenë të kushtueshëm, por nuk ndërrohet ekipi.

**"Epoka e re":** *Nuk mendoni se do të ketë zgjedhje të reja dhe se kjo opozitë mund ta rrëzojë koalicionin qeverisës?*
**Shala:** Jo, nuk do të ketë zgjedhje. Këtë e dinë shumë mirë edhe LDK-ja edhe Vetëvendosja. Madje e dinë se edhe po të kishte zgjedhje nuk do të mund t'i fitonin ato. Zgjedhjet varen edhe nga ndërkombëtarët të cilët në asnjë mënyrë nuk do të lejojnë që në këtë fazë të shkohet në zgjedhje. Zgjedhje nuk do të ketë.

**"Epoka e re":** *Nëse nuk do të ketë zgjedhje, si do të mund të vazhdohet më tutje kur Kuvendi është bërë jofunksional?*
**Shala:** Në këtë fazë askujt nuk i konvenon që Kuvendi të jetë funksional sepse, po të ishte Kuvendi i përgjegjshëm, do të kërkonte përgjegjësi nga Thaçi për procesin e dialogut. Është krijuar një kaos artificial, ndoshta i qëllimshëm. Procesi i dialogut në mënyrën se si është duke shkuar nuk kërkon institucione të qëndrueshme dhe nuk kërkon Kuvend funksional.

## Veseli fton udhëheqësit e partive të diskutojnë sot për dialogun

**Prishtinë, 22 korrik** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka ftuar udhëheqësit e partive politike parlamentare në Kosovë që ta mbajnë sot (e hënë) takimin nga ora 10:00, me qëllim të arritjes së konsensusit kombëtar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. "Me qëllim të arritjes së konsensusit kombëtar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi, në mënyrë që në këtë proces të rëndësishëm të kemi një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, kam kënaqësinë t'ju ftoj në një takim të përbashkët në mes të udhëheqësve të partive politike parlamentare", thuhet në ftesën e kryetarit të Kuvendit.

Në këtë ftesë thuhet se spektri politik në vend, të gjitha së bashku, pozitë dhe opozitë, duhet të jetë i konsoliduar, unik dhe i përgatitur. "Dialogu Kosovë - Serbi, i cili ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe mbështetet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka për qëllim normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, njohjen reciproke, si dhe ta siguroj ulësen e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara", vazhdon ftesa.

Në ftesë thuhet se Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta ketë rolin kryesor të mbikëqyrjes dhe vendimmarrjes në këtë proces të rëndësishëm. "Bashkëngjitur, ju lutem, gjeni dokumentin kornizë për dialogun Kosovë - Serbi, si një bazë për ta diskutuar dhe plotësuar bashkërisht. Propozoj që takimi i parë të mbahet të hënën, më 23 korrik, në orën 10:00, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Salla C 301. Takimi do të jetë i mbyllur dhe secili subjekt politik mund të përfaqësohet në bazë të formatit 1+1", përfundon ftesa.



# MPJ: Serbia po shet e fal armë për ta penguar njohjen e Kosovës



Prishtinë, 22 korrik (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës ka shprehur shqetësimin e thellë mbi publikimin e dëshmive bindëse nga organizatat kredibile ndërkombëtare, siç është "Amnesty International", se armatimi i prodhuar në shtetin serb vazhdon të përdoret nga disa shtete afrikane, të cilat bëjnë shkelje sistematike të të drejtave të njeriut, madje përdoren edhe nga luftëtarët e Organizatës Terroriste Boko Haram. "Ministria e Punëve të Jashtme thërret komunitetin ndërkombëtar që ta rrisë kontrollin, verifikimin dhe mbikëqyrjen e sjelljeve dhe veprimeve të tilla të shtetit serb në kontinentin afrikan, të cilat në mënyrë të tërthortë u kontribuojnë abuzimeve të të drejtave themelore të njeriut dhe kërcënimit serioz të paqes dhe sigurisë", është thënë në reagimin e MPJ-së e cila drejtohet nga ministri Behgjet Pacolli. Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës ka vlerësuar se publikimi i këtyre dëshmive forcon bindjen se Serbia ka përdorur dhe po përdorë shitjen dhe faljen e armëve si mjet të diplomacisë për t'i joshur disa shtete jonjohëse të Republikës së Kosovës në kontinentin afrikan, që mos të ndërmarrin një hap të tillë.

# Alarmon policia: Gjendja e sigurisë në rrugë, shqetësuese

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU




Prishtinë, 22 korrik - Policia e Kosovës ka shprehur shqetësim për situatën e sigurisë dhe numrin e madh të aksidenteve me fatalitet në rrugët tona. "Me gjithë angazhimet e Policisë së Kosovës, masat e vazhdueshme operacionale, duke përfshirë edhe fushatat sensibilizuese dhe apelet për një kujdes për siguri më të madhe në trafik, referuar statistikave të 24 orëve të fundit, bëhet me dije se janë evidentuar dy aksidente me fatalitet", është theksuar në komunikatën e policisë.

Policia e Kosovës ka vlerësuar se situata e sigurisë në rrugët tona mbetet ende shqetësuese. "Aksidentet në përgjithësi, e sidomos humbja e jetëve njerëzore në aksidente trafiku, është shqetësuese jo vetëm për policinë, por edhe për institucionet e tjera dhe qytetarët në përgjithësi, prandaj kërkohet dhe apelojmë për një përkushtim dhe qasje më gjithëpërfshirëse proaktive, për një gjendje më të mirë", është thënë në këtë komunikatë.

Policia e Kosovës ka bërë me dije se me njësitet e veta në kuadër të fushëveprimit të vet vazhdon ta monitorojë dhe ta menaxhojë situatën në trafikun rrugor nëpër të gjitha rrugët e vendit aty ku pjesëmarrësit bien ndesh me rregullat në trafik. "Masa ndëshkuese ligjore do të aplikohen me qëllim të parandalimit të rasteve të aksidenteve, në veçanti atyre me fatalitet që po paraqesin shqetësim për të gjithë dhe po shkaktojnë humbje të jetëve njerëzore", thuhet në komunikatën e policisë.

# Shqipëri - Kosovë, protokoll bashkëpunimi për sezonin turistik



Tiranë, 22 korrik - Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Bejtush Gashi dhe homologu i tij nga Shqipëria, Fatmir Xhafaj, kanë nënshkruar marrëveshjen e protokollit të bashkëpunimit për sezonin turistik veror. Ky protokoll i bashkëpunimit ka qëllim shtimin e marrëdhënieve për ta forcuar bashkëpunimin midis policive të dy vendeve nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të masave të përbashkëta në fushën e kontrollit kufitar. Ai do të kryhet sipas drejtimit të lëvizjes së qytetarëve dhe mjeteve, ku punonjësi i policisë shqiptare kryen regjistrimin në dalje të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe punonjësi i Policisë së Kosovës kryen regjistrimin në hyrje tëterritorit të Republikës së Kosovës.

Procedurat e përbashkëta mund të ndryshojnë ndërmjet negociatave dhe me miratim të ndërsjellë. Gjatë zbatimit të këtyre procedurave të kontrollit të përbashkët do të mbahet lista e përpunimit të automjeteve me procedurë të lehtësuar

## Hasani: Serbët e duan Asociacionin si kategori kushtetuese



Prishtinw, 22 korrik - Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe profesori i së Drejtës ndërkombëtare, Enver Hasani, ka thënë se në rast se realizohet kërkesa e palës serbe, që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe të themelohet me ligj të veçantë, atëherë duhen bërë ndryshime kushtetuese që do ta bënin këtë asociacion kategori kushtetuese. Ai ka thënë për "Kosovapress" se me këtë formë serbëve të Kosovës, që kontrollohen dhe ndikohen nga Beogradi, do t'u jepet fuqia e plotë mbi këtë asociacion për të marrë vendime brenda Kosovës pa e pyetur Qeverinë e Kosovës.

# Kosova dhe Serbia, të ‘shtrënguara’ ta përmbyllin demarkacionin e kufirit

Demarkacioni apo shënjimi i vijës kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të jetë një proces i domosdoshëm për të dyja vendet. Përveç si nevojë për normalizimin e raporteve, demarkacioni pritet të jetë kusht i BE-së edhe në proceset integruese për Kosovën dhe Serbinë



PRISHTINË, 22 KORRIK - Bashkimi Evropian ua ka bërë të qartë të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor se me strategjinë e re të zgjerimit se nuk mund t'i bartin problemet dhe konfliktet e tyre brenda BE-së dhe se ato duhet t'i zgjidhin para se ta pretendojnë anëtarësimin gjatë viteve të ardhshme.
Kryetari i Komisionit Shtetëror për Shënimin dhe Mirëmbajtjen e kufirit të Kosovës, Shpejtim Bulliqi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova ka potenciale të mjaftueshme për t'iu qasur çështjes së demarkimit të kufirit me shtetin e Serbisë. "Nevojitet një përkrahje institucionale dhe një bashkëpunim i mirëfilltë ndërinstitucional për arsye se ekipi i cili do të jetë pjesë e këtyre bisedimeve, sigurisht se ka nevojë për të dhëna dhe materiale të ndryshme hartografike të cilat do të ndihmojnë në kurorëzimin me suksese të kësaj pune", ka thënë Bulliqi. Sipas ekspertëve, Kosova deri në dhjetor të vitit 1988 i ka pasur kufijtë administrativ`, kufij këta që i ka njohur edhe plani i presidentit Ahtisaari në bazë të t` cilit edhe ishte shpallur pavarësia e Kosovës, i cili respektonte kufijtë e Kushtetutës së vitit 1974 (kur Kosova ishte krahinë autonome në kuadër të ish-Jugosllavisë).
Shpejtim Bulliqi thekson se çështja e shënjimit të kufirit duhet të zgjidhet pas diskutimeve të cilat duhet të bëhen nga komisionet përkatëse të Kosovës dhe Serbisë. Ai thotë se ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për të punuar rreth shtrirjes së vijave kufitare mes dy vendeve. "Kosova duhet ta ruajë kufirin administrativ të dikurshëm dhe besoj se ky proces do të ishte përmbyllur në formën më të mirë po qe se arrihet të ruhet ky kufi administrativ i cili ka ekzistuar. Është një fat i madh që edhe disa ndryshime të cilat kanë ndodhur në vijën administrative midis Kosovës dhe Serbisë në periudha të caktuara kohore, të gjitha janë të mbuluara me vendime të qarta politike të periudhave dhe kohës së caktuar dhe kësisoj mendoj se nuk ishte dashtë të kishte ndonjë kontest dhe asnjë problem në kuptimin e përcaktimit të vijës kufitare", ka thënë Bulliqi.
Ish-zëvendësministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Bajram Gecaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se në bazë të çështjeve kadastrale me të cilat është punuar edhe për shënjimin e vijave kufitare me shtetet e tjera, Kosova duhet të veprojë njësojë edhe për shënjimin e kufirit me Serbinë. "Ne të gjitha të dhënat kadastrale, sikur i kemi pasur me Maqedoninë, me Malin e Zi, i kemi edhe me Serbinë. Pra, duhet edhe këtu të koncentrohemi në elementin kadastral. Nëse e bëjmë këtë, unë besoj se nuk do të ketë fare problem", ka thënë Gecaj.
Përcaktimi i kufijve është çështje e rëndësishme e sovranitetit shtetëror, thotë Gecaj që, sipas tij, nëse arrihet një marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, edhe çështja e vijës kufitare duhet të jetë e rregulluar me atë marrëveshje. "Unë besoj se problemi me Serbinë është më tepër politik. Pra, fakti se Serbia nuk e njeh realitetin e krijuar në Kosovë se sa që është problemi teknik. Mendoj se nuk do të ketë probleme të aspektit teknik, nëse ata pajtohen që në këto diskutimet përfundimtare ta njohin realitetin e shtetit të Kosovës", ka deklaruar Gecaj.
Pas ratifikimit të marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi, procesky që kishte zgjatur tre vjet, tani Kosovës i mbetet ta rrumbullakojë edhe shënjimin e vijës kufitare me Serbinë.

# Limaj parasheh që deri në shtator të ndërtohet grupi i unitetit për dialog



PRISHTINË, 22 KORRIK - Zëvendëskryeministri i Kosovës dhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka konfirmuar vullnetin e Kosovës për të përmbyllur sa më parë dialogun me Serbinë. Limaj ka thënë se spektri politik në Kosovë, pozitë e opozitë, janë për dialog, i cili, sipas tij, do të ketë si përfundim njohjen e Kosovës. "Kemi kohë të mjaftueshme deri në shtator që Kosova ta ndërtojë grupin e unitetit, një ekip të përbashkët që reflekton konsensusin sa më të gjerë të forcave politike, pastaj të fillojë dialogu, që do të shkojë në një marrëveshje obliguese ndaj të dyja palëve dhe marrëveshje që çon drejt për njohjen e Kosovës", ka thënë Limaj për "Kosovapress". Limaj ka thënë se është koha kur të gjithë duhet të marrin përgjegjësi. Ai ka insistuar se në tema të mëdha nuk duhet të ndahen pozitë e opozitë, por duhet të punojnë bashkë. "Në këtë proces duhet të jetë një konsensus sa më i gjerë i të gjitha forcave politike. Jemi të interesuar të gjithë që ta përmbyllin çështjen me Serbinë që na çon drejt njohjes formale, por ne duhet të dimë afatin, kohën dhe ku është objektivi ynë", ka theksuar Limaj. Sipas Limajt, edhe opozita dëshiron të krijohet një ekip i përbashkët i unitetit dhe të gjithë të punojnë për këtë çështje shumë të rëndësishme për vendin.

# Kërkohet vëmendje institucionale për sigurimin shëndetësor për policinë

Janë rreth 8 000 pjesëtarë me uniformë të Policisë së Kosovës të cilët nuk kanë ende sigurim shëndetësor dhe jetësor. Zëvendëskryetarja e Sindikatës së Policisë së Kosovës, Valbona Kamberi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kërkesa për sigurime shëndetësore ka hasur në vesh të shurdhër nga institucionet. Duke marrë parasysh rrezikshmërinë e punës së policëve, drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku, ka apeluar që sa më shpejt të gjenden alternativa për këtë çështje



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 KORRIK - Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se sigurimet shëndetësore për Policinë e Kosovës janë domosdoshmëri dhe jo luks. "Në kohën në të cilën po kalojmë sigurimi shëndetësor nuk mund të konsiderohet si luks, por domosdoshmëri, sidomos për policinë që janë të ekspozuar karshi rreziqeve", ka thënë ai. Mazreku ka shtuar se sigurimi shëndetësor dhe jetësor i pjesëtarëve policorë në mënyrë automatike do t'ia heqtë një barrë të madhe shtetit të Kosovës për faktin se policia në vazhdimësi është e ekspozuar karshi rreziqeve të ndryshme. Ai ka theksuar se praktika të ngjashme kanë ndjekur edhe vendet e rajonit, shembull Mali i Zi përmes ligjit ka përcaktuar nxjerrjen e akteve nënligjore që mundësojnë njohjen e të drejtave të policëve nga sigurimi pensional dhe invalidor. "Po ashtu, edhe në praktikën e Serbisë kjo çështje është rregulluar në atë mënyrë që, përveç sigurimit shëndetësor që është i obligueshëm me ligj për të gjithë qytetarët, pjesëtarët policorë gëzojnë trajtim mjekësor përtej kufizimeve të cilat janë përcaktuar me Ligjin për sigurimin shëndetësor të obligueshëm, që rrjedhin si pasojë e detyrës që kryejnë, kërcënimeve për shëndetin dhe jetën e tyre, si dhe në çështjet e tjera që ndikojnë në uljen e kapacitetit të punës", ka thënë Mazreku, duke shtuar se është e domosdoshme që në mungesë të sigurimit shëndetësor, Qeveria e Kosovës të ndërmarrë veprime për ndarjen e fondeve të nevojshme për sigurimin e shëndetit dhe jetës së policëve të Kosovës.

Në këtë drejtim ai ka pohuar se rreziku dhe detyrimi për kompensimin e rasteve që do të ndodhin do të bartet te kompanitë e sigurimit. Sipas Mazrekut, në këtë mënyrë buxheti i shtetit do të lirohet nga shpenzimet shtesë për këtë qëllim. Ai ka shtuar se mungesa e fondeve është arsyeja kryesore e zvarritjes së kësaj çështje. "Që nga fillimi i ofrimit të sigurimit shëndetësor kompanitë e sigurimeve janë dëshmuar se kryejnë obligimet ndaj palëve me përgjegjësi të lartë. Vazhdimisht kemi biseduar me përfaqësues të Sindikatës së Policisë së Kosovës, me zyrtarë të lartë të menaxhmentit të policisë, si dhe me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku u kemi ofruar të gjitha informacionet e nevojshme që ata kanë kërkuar. Mungesa e fondeve ka qenë arsyeja e vetme që policët e Kosovës deri më tash nuk kanë sigurim shëndetësor. Shpresojmë se në të ardhmen kjo çështje do të zgjidhet dhe policia do të trajtohet njëjtë sikurse në vendet e rajonit dhe më larg. Ne jemi munduar që disa herë t'ia bëjmë me dije zyrës së kryeministrit domosdoshmërinë e sigurimit të shëndetit dhe jetës për pjesëtarët e policisë", ka thënë ai, duke treguar për komunikimin e fundit që kanë pasur për këtë temë me kryeministrin. "Më 2 maj i kemi shkruar kryeministrit Haradinaj, pas tragjedisë së ndodhur në afërsi të Kaçanikut, ku gjatë detyrës dy pjesëtarë të policisë humbën jetën tragjikisht. Pas kësaj fatkeqësie shoqata jonë në vazhdimësi është munduar t'i sensibilizojnë drejtuesit e institucioneve rreth nevojës urgjente të sigurimit shëndetësor dhe jetësor për pjesëtarët e policisë së Kosovës", ka thënë Mazreku.

Ai ka bërë me dije se ende nuk kanë marrë një përgjigje nga zyra e kryeministrit. "Pavarësisht prej shkresave që ne i kemi dërguar, deri më tani nuk kemi marrë ndonjë njoftim nga ta për të biseduar rreth kësaj çështje shumë të rëndësishme. Shpresojmë se sigurimi shëndetësor dhe jetësor i policëve të Republikës së Kosovës do të bëhet shpejt", ka thënë Mazreku. Ai ka treguar se për çështjen e sigurimit shëndetësor dhe jetësor të policëve disa herë kanë biseduar edhe me përfaqësuesit e Sindikatës së Policisë dhe zyrtarë të lartë drejtues të policisë. "Me kërkesë të Sindikatës së Policisë kemi mbajtur një takim me ushtruesin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Naim Rexha, ku i pranishëm gjatë takimit ka qenë edhe këshilltari i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Policisë ua kemi dorëzuar edhe ofertën konkrete financiare rreth kostos mujore dhe vjetore të sigurimit shëndetësor dhe jetësor të policëve. Të gjitha palët që janë pjesë e procesit kanë shprehur gatishmëri maksimale për ta zgjidhur këtë problem, por derisa nuk ka mjete atëherë nuk ka as rezultat të shpejtë", ka thënë Mazreku.

Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haxhi Shala, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se çështja e sigurimeve shëndetësore për Policinë e Kosovës duhet të jetë prioritet i Qeverisë. Ai ka thënë se pa sigurim shëndetësor të policëve Kosova nuk mund të jetë pjesë e organizatave ndërkombëtare si Interpol dhe Europol. "Jo vetëm polica, por askush nga institucionet e Kosovës deri më sot nuk është menduar të kenë sigurime shëndetësore, përveç punëtorëve të Postës. Sidoqoftë, çështja e Policisë është diçka e veçantë që shteti, ministrat e linjës dhe kryeministri duhet të mendojnë seriozisht që Policia e Kosovës të ketë sigurime sepse çdo ditë janë të rrezikuar në punë. Ne po synojmë të jemi në Interpol dhe Europol dhe pa sigurime shëndetësore nuk mund të jemi pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë. Andaj Qeveria e Kosovës duhet të merret seriozisht me këtë çështje", ka thënë Shala, i cili ka bërë me dije se këtë temë si komision e kanë trajtuar edhe me Sindikatën e Policisë së Kosovës.

Lulzim Rafuna, këshilltar i ministrit të Financave, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Ministria e Financave i vendos në projektbuxhet kërkesat të cilat janë nga organizatat buxhetore duke marrë parasysh edhe mundësitë buxhetore. Ai ka theksuar se pritjet e tyre janë që sa më shpejt të fillohet zbatimi i reformave të sigurimeve. "Pritjet tona janë që të fillohet sa më shpejt zbatimi i sigurimeve", është shprehur ai.

Valbona Kamberi, zëvendëskryetare e Sindikatës së Policisë së Kosovës, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se prej vitesh janë duke kërkuar që Policia e Kosovës të këtë sigurime shëndetësore. Ajo ka thënë se kanë kërkuar të kenë sigurime alternative deri në miratimin e Ligjit për sigurime shëndetësore në Kosovë, por që kjo çështje ka hasur në "vesh të shurdhër". "Ka qenë kërkesë e jona e kamotshme që Policia e Kosovës të ketë sigurime shëndetësore dhe jetësore, mirëpo ende kërkesa jonë nuk ka marrë përgjigje. Kemi bërë kërkesë në Qeveri për sigurime në kuadër të punës që po bëjmë, mirëpo deri më tani nuk kemi asnjë përgjigje. Kemi kërkuar sigurime alternative derisa të hyjë në fuqi Ligji për sigurime shëndetësore. Në takimet e fundit kishte shumë variabla që të bëhet sigurimi jetësor dhe aksidental, mirëpo jo edhe sigurimi shëndetësor. Në Policinë e Kosovës janë 8 700 punonjës pa sigurime shëndetësore, kurse në uniformë janë 8 000 pjesëtarë", ka bërë me dije Kamberi.

# Në Iowa promovohen mundësitë për investime në Kosovë

**Prishtinë 22 korrik (ER)** - Nën organizimin e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në shtetin amerikan të Iowas, si dhe me mbështetje të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka promovuar në Des Moines të Iowas mundësitë për investime në Kosovë. Në këtë aktivitet morën pjesë biznese dhe shefa ekzekutivë të asociacioneve të biznesit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përfaqësues të Federatës Botërore të Odave Ekonomike, por edhe shteteve të tjera si Brazili, Australia, Franca, Ishujt Kajman etj.

Në hapje të këtij aktiviteti, konsulli i përgjithshëm i Republikës së Kosovës në Iowa, Xhavit Gashi, ka folur për zhvillimet e Kosovës si dhe për partneritetin e veçantë shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Iowas. Ai ka falënderuar autoritetet ushtarake, ekonomike, edukative dhe kulturore të Iowas për avancimin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve në shumë fusha të tjera.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se pavarësisht se Kosova është shtet i ri, ka shënuar përparim të madh në aspektin e të bërit biznes, që është reflektuar edhe në raportin e Bankës Botërore që matë lehtësinë e të bërit biznes, por edhe atë të "The Heritage Foundation", i cili mat liritë ekonomike globale, i cili rendit Kosovën shumë më mirë se shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Ai ka njoftuar përfaqësuesit e pranishëm të bizneseve për vendimin e Qeverisë së Kosovës për themelimin e Zonës së Veçantë Ekonomike Amerikane në qytetin e Gjakovës.

Zeka ka theksuar se investitorëve potencialë amerikanë brenda zonës do t'u ofrohet tokë pa pagesë, lirim nga dogana për linja të prodhimit dhe lëndë e parë, depo doganore brenda zonës, si dhe një zyrë e cila do t'i kryente të gjitha procedurat e aplikimit për leje ndërtimi dhe leje të tjera operative në emër të kompanive amerikane. Ai ka shtuar se Kosova ofron një mjedis miqësor për kompanitë amerikane, ndërsa zona si e tillë është model unik në rajon dhe më gjerë e dedikuar për kompanitë amerikane.

Në këtë aktivitet i pranishëm ishte edhe gjenerali Timothy Orr, komandanti i Gardës Nacionale të Iowas, Kim Heidemann nga organizata e Shteteve Simotra të Iowas dhe Debi Durham, drejtoreshë e Autoritetit të Zhvillimit Ekonomik të Iowas. Kjo e fundit organizoi edhe një takim për kompaninë amerikane "Ideal Energy", e cila prezantoi para konsullit të përgjithshëm dhe drejtorit të Odës Ekonomike Amerikane, planin e tyre për investime në gjenerimin e energjisë alternative në Kosovë.



## Komuna e Prishtinës për gjashtë muaj realizon 12 milionë euro të hyra

**Prishtinë, 22 korrik** - Taksa për leje ndërtimi, tatimi në pronën e paluajtshme, taksa për certifikata dhe dokumente zyrtare, licenca në biznes dhe qiraja në banesa janë disa nga format që Komuna e Prishtinës realizon të hyra.

Për gjashtë muajt e parë të këtij viti qeverisja e Prishtinës ka arritur t'i mbledhë mbi 12 milionë euro nga këto taksa. Më së shumti kjo komunë ka mundur të mbledhë nga Tatimi në Pronën e Paluajtshme në total prej 3.76 milionë eurosh, ndjekur nga Taksa për Leje Ndërtimi me 3.51 milionë euro dhe nga infrastruktura rrugore me 814 mijë euro të hyra.

Komuna e Prishtinës nga gjobat në trafik për gjashtë muaj ka grumbulluar mbi 630 mijë euro, ndërsa nga mbeturinat janë mbledhur mbi gjysmë milion euro.

Të hyra kjo komunë ka realizuar edhe nga Taksa për Shërbime Arsimore dhe Taksa për Shërbime Shëndetësore në total rreth 617 mijë euro.

*(Telegrafi)*





Shijo
Pranverën
me...
Jaffa
Champion
PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L




ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
0.5L

## Presidenti iranian paralajmëron Trumpin për provokime



TEHERAN, 22 KORRIK - Presidenti iranian Hassan Rouhani i ka tërhequr vërejtjen presidentit amerikan Donald Trump për provokimet ndaj shtetit të tij. Trumpi më herët këtë vit kishte ndërprerë marrëveshjen bërthamore me Iranin dhe kishte urdhëruar ngritjen e sanksioneve.
Mediet lokale në Iran kanë raportuar deklaratën e Hassan Rouhanit ndaj Trumpit i cili thotë se "Mos luani me bishtin e luanit, sepse do të pendoheni". Trumpi kishte sugjeruar që liderët iranianë ta thërrasin për ta arritur një marrëveshje, por Irani kishte refuzuar bisedimet. Rouhani ka shtuar se "paqja është ende e mundshme dhe se Amerika duhet të kuptojë që paqja me Iranin është nëna e të gjitha luftërave".

# Strategjia amerikane për ta parandaluar ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet e ardhshme

Zyrtarët po marrin masa për ta parandaluar - në zgjedhjet e mesit të mandatit në ShBA - një përsëritje të ndërhyrjes ruse, të diktuar nga shërbimet amerikane të zbulimit gjatë zgjedhjeve të 2016-s, e një ndër këto masa është edhe një sistem që lajmëron publikun për ndërhyrjet e huaja




UASHINGTON, 22 KORRIK - Zgjedhjet e mesit të mandatit në Shtetet e Bashkuara janë më pak se katër muaj larg. Zyrtarët po marrin masa për të parandaluar një përsëritje të ndërhyrjes ruse, të diktuar nga shërbimet amerikane të zbulimit gjatë zgjedhjeve të 2016-s, e një ndër këto masa është edhe një sistem që lajmëron publikun për ndërhyrjet e huaja. "Asgjë nuk është më e shenjtë për demokracinë sesa zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Votuesit vijnë me besimin se vota e tyre ka rëndësi. Por, kjo premisë është sulmuar qëkur u zbulua se Rusia ndërhyri në zgjedhjet e 2016-s. Ligjvënësit thonë se pjesa e parë e strategjisë është fillimi i sanksioneve. I kemi vendosur sanksione Rusisë, si një mënyrë që ta mbajë përgjegjësinë. Për më tepër, po sigurohemi që mos ta përsërisin dot", tha Paul Ryan, kryetar i Dhomës së Përfaqësuesve.
Por, koha nuk premton. Po afrohen me shpejtësi zgjedhjet e mesmandatit që mbahen në muajin nëntor, kur votuesit gjykojnë për punën e një presidenti të ri, duke ruajtur, apo duke zëvendësuar ligjvënësit në Kongres. "Ky amendament është reagimi ynë, në partneritet me shtetet amerikane, për t'i përplasur derën në fytyrë ariut rus, apo çdo rreziku tjetër që synon ta godasë integritetin e zgjedhjeve tona", tha ligjvënësi demokrat Steny Hoyer.
Departamenti i Drejtësisë po paralajmëron tashmë publikun për ndërhyrjen e huaj në procesin zgjedhor. Në thelb të strategjisë është vigjilenca e votuesve. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm, Rod Rosenstein, thotë se keqbërësit kibernetikë vendosën në objektiv 21 shtete amerikane gjatë zgjedhjeve të fundit. "Nuk kemi prova se ndonjë qeveri e huaj ia doli mbanë ta ndryshojë votën, por rreziku është real", deklaroi Rosenstein.
Ndërkaq, kritikët e administratës fajësojnë presidentin Trump për faktin që nuk krijoi një task forcë të posaçme, apo që nuk emëroi një drejtor të sigurisë kibernetike. Analistja Elaine Kamarck flet për rreziqet që sjell mosveprimi. "Do të na kontrollonte Rusia. Duke pasur njerëz të cilët, me apo pa ndërgjegje, i janë mirënjohës një fuqie të huaj që nuk beson te demokracia", thotë ajo.
Presidenti Trump thotë se administrata e tij po bën gjithçka të mundshme për ta parandaluar ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet që vijnë. Kanë mbetur, megjithatë, vetëm 100 ditë për t'i ndërtuar strategjitë për këtë qëllim.

# Në Britani një trevjeçar sulmohet me acid




Londër, 22 korrik - Një djalë trevjeçar është plagosur rëndë nga një sulm i dyshuar me acid në një dyqan në Worcester të Britanisë së Madhe. BBC raporton se djali u sulmua me dashje në Home Bargains në orën 14:15 të së shtunës. Lajmi është konfirmuar edhe nga efektivja e policisë Mercia West, teksa djaloshi po trajtohet në spital për djegie të rënda në krah dhe fytyrë.
Një 39-vjeçar nga Wolverhampton është arrestuar në lidhje me incidentin në Shrub Hill Retail Park, Tallow Hill. 39 vjeçi u arrestua për kryerjen e lëndimeve të rënda trupore dhe mbetet në paraburgim. Ndërkohë policia publikoi imazhe të marra nga kamerat ÇTV. "Të tre burrat në foto mund të kenë informacion vital për hetimin tonë", tha Suput Travis. "Unë jam i sigurt se dikush do t'i njohë ata dhe unë do t'i kërkoja kujtdo që për çdo informacion të na kontaktonin pasi është një çështje e ndejshme dhe urgjente. Incidenti ka shokuar me të drejtë komunitetin lokal dhe do të dëshiroja të siguroja njerëzit se ne po kryejmë një hetim tërësor për të identifikuar ata që janë përgjegjës", tha zyrtari i policisë.

## Presidenti kinez Xi Jinping nis një turne afrikan



PEKIN, 22 KORRIK - President i Kinës, Xi Jinping, ka filluar një turne katërditor në disa vende afrikane. Fillimisht ai shkoi në Senegal, ku nënshkroi marrëveshje dypalëshe me vendin që ka një rritje të shpejtë ekonomike. Kina e ka shtuar praninë e saj në Afrikë, me investime, hua dhe marrëveshje të shumta me vendet afrikane, që ndihmojnë në përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së këtyre vendeve. Këto projekte i kanë siguruar Pekinit qasje në tregjet e rëndësishme për ekonominë kineze. Kina ka lidhje të rëndësishme tregtare me kontinentin. Në turneun afrikan të Xi përfshihen vizita në Ruandë, Mauritani dhe në Afrikën e Jugut. Në Afrikën e Jugut ai do të takohet me zyrtarë nga të ashtuquajturit BRICS, ku bëjnë pjesë vende me rritje të shpejtë ekonomike, si Brazili, Rusia, India, dhe Afrika e Jugut.

# EKREM BARDHA, shqiptaro-amerikani që loboi aq shumë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës



Foto: Presidenti Hashim Thaçi vlerëson me dekoratën më të lartë të shtetit të Kosovës për Lirinë dhe Pavarësin e Kosovës, z. Ekrem Bardha themeluesin e Lobit Shqiptaro-Amerikan

**- Shqiptari që takoi gjashtë presidentë amerikanë, sekretarë shteti, senatorë, kongresmenë, ambasadorë...**

**U arratisë nga Shqipëria, por kurrë dheun, vendin e vet, nuk e tradhtoi. Kosova ishte zemra e tij.**



Shkruan: **Ferdinand SAMARXHI,**
***Fitues i Antenës së Artë Mjeshtër i Madh***

## Në vend të prologut...

Në Panteonin e artë të kombit, luftëra, epope, njerëz, lanë të skalitur, data, vende, ngjarje, figura që në udhëtimin e gjatë ndriçuan si yje në gjerdanin e tij të historisë.
Që nga fillimet e gjenezës, që edhe pse kohët me mjegullnajën dhe thellësitë e shekujve kërkojnë t'i zvenitin, ato më shumë ndriçojnë, me inkandeshente rrezatojnë historinë tonë. Që në zanafillë shkëlqen Panteoni ynë.
Kur ju të arrini në tokën e molosëve të sipërm atje do të gjendet tempulli më i lartë. Ai është tempulli Thesprot. Eskili, Prometeu i lidhur në vitin 538.
Prej këtu ku nis e njihet historia. Panteoni ynë gjithnjë do të shkëlqejë, me perandorë me origjinë ilire, me Pirron, Teutën, me shtatë papë iliro shqiptarë, me heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, me Ali Pashë Tepelenën, me Bushatllinjtë e Shkodrës, me vëllezërit Frashëri, ideologët e platformës të çlirimit kombëtar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me plakun e urtë e të mençur Ismail Qemalin që do ta ngrehte në Vlorë flamurin, me dom Nikoll Kaçorrin, Aqif Pashë Elbasanin, Isa Boletinin e Luigj Gurakuqin. Gjithmonë posedues Panteoni ynë dhe në vazhdën e tij.
Nënë Tereza, lavdia e kombit, kardinal princ botëror i Kishës, Ernest Troshani, sakrilegj i provincës hyjnore e matanë detit në anën tjetër të kontinentit, Fan S. Noli, Faik Konica, Fishta etj.
…Dhe në ditët e sotme do të skaliteshin në këtë Panteon lufta heroike e UÇK-së, komandanti legjendar Adem Jashari, udhëheqësi politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, komandanti trim Ramush Haradinaj, diaspora amerikane, lobi i saj me shqiptaro-amerikanët që punuan me zemër dhe zjarr për vatanin, për lirinë e Kosovës. Sa më shumë viziton Panteonin më e gjallë bëhet historia, më të madhërishëm bëhen njerëzit që punuan për ta ndriçuar dhe lartësuar gjithnjë e më shumë.




Foto: Takim i përzemërt i lobistit të madh të çështjes shqiptare, z. Ekrem Bardha me Presidentin Amerikan George Bush

...Në skalion të këtij Panteoni qëndron figurshëm dhe një prej shqiptaro-amerikanëve që loboi fort, që zemra i rrahu shumë për vendin e tij, Kosovën, për fatet e popullit të tij. Ky është Ekrem Bardha, njeriu që edhe pse u arratis nga Shqipëria, kurrë vendin e vet nuk e tradhtoi, por më shumë e deshi dhe pse vendi i tij ishte nën thundrën e kuqe të komunizmit.
...Tek po hynim në Kosovë, vëreja që burrin që kisha në krah dhe pse e kishte për të tretën herë që hynte në tokën martire të Kosovës, sytë po i lageshin, bulbëza të ndritshme pika-pika po binin një e nga një mbi mollëzat e faqeve të tij. Me këtë skenografi të syve të lotuar të tij mu drejtua: "Gazetar, Ferdinand, akoma më duket ëndërr që po hyjmë në Kosovën e lirë, në tokën martire".
…Po udhëtonim drejt Prishtinës ku presidenti Thaçi me rastin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës dhe të 242-vjetorit të pavarësisë së ShBA-së kishte ftuar për ta falënderuar njeriun që bëri aq shumë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, lobuesin e zjarrtë dhe bashkëthemeluesin e lobit shqiptaro-amerikan, Ekrem Bardhën dhe më vajzën e tij, Donika Bardha.
3 korrik. Pritje emocionuese. Dy burra përmallen dhe shtrëngohen fort. Udhëheqësi politik i UÇK-së, presidenti i sotëm i Kosovës, Hashim Thaçi dhe shqiptaro-amerikani Ekrem Bardha, me vajzën e tij, Donikën, që të pamundurën bënë për Kosovën, që ajo sot të ishte e lirë.
Fjalët janë të pakta, prekëse, kujtimet e takimeve e të luftës, janë të shumta. Rrjedhin natyrshëm ashtu siç ndodhen, siç u përjetuan. Të dy burrat me devocion flasin për përpjekjet, për takimet, për gjenocidin e egër që ndodhi, për luftën, për emigrimin e shqiptarëve.
Bashkëbiseduesit theksuan se lufta heroike e UÇK-së ngriti popullin që t'i rrëmbente armët dhe t'i dilte zot dhe t'i bënte ballë luftës së egër të Serbisë.
Ashtu siç ishte dhe lufta që bëri diaspora shqiptaro-amerikane, lobi i saj që arriti ta ndërgjegjësojë shtetin amerikan, presidentët, senatorët, kongresmenët, ambasadorët për thyerjen e mitit të statusit të veçantë të shtetit të favorizuar që gëzonte Republika Jugosllave në ShBA me gjenocidin e egër që po ushtrohej ndaj popullit shqiptar të Kosovës. Luftë e vështirë, fakte kokëforte, gjenocid i papërë. Bisedime kokë me kokë me miq të mëdhenj amerikanë, derisa u arrit në marrjen e vendimit për sulm.
Kosova është dhe do të jetë gjithë jetën mirënjohëse diasporës amerikane, lobit të saj, në veçanti juve zoti Bardha si një ndër themeluesit, udhëheqësit kryesor të saj, patriotizmit dhe shqiptarizmit tuaj, vajzës suaj, Donikës dhe gjithë familjes suaj.
4 korriku, dita e 242-vjetorit të pavarësisë së ShBA-së. Ditë feste e shënuar dhe ngjarje e madhe dhe për Kosovën, për ShBA-në, shtetin që zë vendin e artë në Panteonin e



Foto: Vajza e z. Ekrem, Donika Bardha dekorohet me medaljen më të lartë të shtetit: Për kontributin për Liri dhe Pavarësinë e Kosovës



historisë së Kosovës.
Një pritje me veneracion. Takim kuptimplotë. Dje udhëheqësi politik i UÇK-së, sot president i shtetit më të ri në hartën e botës, Hashim Thaçi, nis festën me pritjen e shqiptaro-amerikanit, Ekrem Bardha dhe vajzës së tij, Donikës.
Pikërisht sot, në ditën e festës së shtetit tuaj, ShBA-së, ndihem i motivuar që të mos harroj kurrë, vlerësoj dhe ta quaj të pamohueshme garancinë për bashkërritjen e fitores me luftën e madhe që bëri ShBA-ja, presidenti Bill Clinton, NATO-ja për shkatërrimin e regjimit militar të egër serb, që Kosova sot është e lirë. Po kështu ndihem aq i motivuar edhe për luftën e madhe të palodhur që bëri diaspora shqiptaro-amerikane, lobi saj në krye me ju, që luftoi pareshtur që në ditët e para të bindur edhe kur nuk besohej së Kosova do të çlirohej. Një punë e jashtëzakonshme, atdhetare e patriotike që Kosova kurrë nuk do ta harrojë. Dekorata e sotme më e lartë e shtetit të ri të Kosovës e akorduar për ju dhe vajzën tuaj, Donikën, me motivacion për kontributin tuaj për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, me të cilën janë nderuar dhe presidenti Bush dhe Clinton, është një mirënjohje dhe dashuri e veçantë për ju që luftuat për Kosovën dhe sot ju jeni jo vetëm një faktor lidhjeje dhe bashkëpunimi midis Kosovës dhe ShBA-së që bëri aq shumë për ne, por vazhdoni të loboni ende për rritjen e prestigjit të shtetit të ri të Kosovës. Duke falënderuar presidentin Thaçi për mirënjohjen e punës dhe luftës së tyre dhe duke i uruar ecje të mëtejshme shtetit të ri të Kosovës, bashkëbiseduesit u përqafuan duke uruar njëri-tjetrin për 242-vjetorin e pavarësisë së ShBA-së dhe 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës.
Natyrshëm jeta, puna dhe lufta e zotit Bardha është një faqe e artë në historinë e Panteonit tonë që flet dhe motivon shumë.


The Greek government will receive no preferential treatment territorially or otherwise. all American regardless of national origin are equally my special concern.
Richard Nixon
And I have a special interest in all the people who live under Communist Oppression
RN

Foto: Letër origjinale e shkruar me dorë nga presidenti amerikan Nikson, Greqia nuk do të aneksojë tokat e Shqipërisë së Jugut, Vorio-Epirin, dhënë si dokoment z.Bardha

*Zoti Bardha, jemi të interesuar të bashkëbisedojmë me ju, për të shfletuar faqe të reja të historisë se panteonit tonë të artë. U larguat nga Shqipëria, nga Kolonja, në moshën 20-vjeçare. U arratiset pa ditur se a do të ishit gjallë matanë kufirit. Ç'ju shtyri të kishit ende dhimbje për Shqipërinë, të mos tradhtonit kurrë atë?*



Foto: Z. Ekrem Bardha sensibilizon senatorët amerikanë: Këtu bie Kosova

**Ekrem Bardha**: Vendosa të arratisem. Samiu, vëllai im i madh, ndodhej i burgosur, ndërsa Niaziu, vëllai tjetër dhe katër dajallarët, ishin arratisur. Ndodhesha në repartin e punës, ku si i deklasuar nuk shihesha me sy të mirë. Mbasi mora leje nga reparti i punës u nisa me shpejtësi në Radanj dhe tashmë kisha marrë vendimin e prerë ose do të arratiseshim së bashku me nënën dhe vëllezërit, ose fati ynë nuk dihej si do të shkonte. Nëna nuk më jepte përgjigje, por e kuptoja që arsyeja e vetme ishte Samiu i burgosur, si mund ta linim atë. Për një moment m'u duk sikur nëna u lëkund kur i përmenda se, përveç Samiut, ajo kishte edhe tre djem të tjerë, të cilët nuk duhet t'i humbte. Më në fund ajo pranoi dhe unë kurrë nuk mund ta harroj atë çast. Por, zemra e saj do të mbetej në birucat e burgut të Korçës, ku ndodhej Samiu, djali i saj.
U nisem para mesnatës, nëna, unë dhe dy vëllezërit më të vegjël, Myfitiu e Agimi. Në një moment nëna ndali dhe më thotë se unë mund të vazhdoja me vëllezërit, mbasi ajo nuk mundte më. Por të ikja vetëm me vëllezërit dhe ta lija nënën nuk kishte kuptim, kështu i thashë që o të gjithë bashkë ose asnjë. E mora nënën mbi shpinë dhe duke tërhequr dhe vëllezërit e vegjël kaluam dhe dy-tre qind metrat e fundit. Ishim në tokën greke. Na shoqëruan në Janinë ku na mbajtën të izoluar rreth 2 muaj. Qëllimi i tyre ishte t'i rekrutonin të arratisurit dhe t'i bënin bashkëpunëtorë me Asfalinë greke. E kisha vendosur që kurrë nuk do t'u shërbeja grekëve. Mbasi e kuptuan që nuk mund të na bindnin atëherë, mbas 2 muaj na transferuan në kampin e Llavros. Ndodhi një e papritur e madhe mbasi takuam Kajain, vëllanë e nënës dhe mbas shumë përpjekjesh ne e lamë kampin e Llavrios dhe shkuam familjarisht në Gjermani, ku takuam vëllanë, Niaziun. Pas disa muajsh Niaziu na lajmëroi që ishte aprovuar kërkesa për bashkim familjar dhe me anije u nisëm për në ShBA.

*Si i përjetuat ju vitet 1957-1968 që nga hyrja juaj në ShBA?*
**Ekrem Bardha:** Janë vite pune të papara të palodhshme në një shtet të lirë e demokratik, ku ligji, drejtësia shpreh të gjitha te drejtat e njeriut, puna paguhej e çdo gjë që e fitoje me djersën tënde ishte dhe bëhej pronë dhe pasuri e njerëzve. Ne shqiptarët e donim punën, e çmonim dhe e vlerësonim atë pavarësisht vendit tonë ku nuk respektoheshin të drejtat dhe liritë themelore të jetës, si garantimi i jetës, i punës dhe pjesëmarrja në të gjitha veprimtaritë politike-shoqërore, kulturore e sociale. Në këto vite, ndjenja e patriotizmit që me buronte si shqiptar, më bëri të aktivizohem me shumë për çështjen e kombit tim, të bëja sa më shumë për të dhe të ndihmoja me çka ishte me e mundur.



Foto: Pritje solemne me rastin 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës dhe 242-vjetorit të pavarësisë ShBA-së

*Patriotë të shumtë të kombit tonë luftuan dhe punuan për çështjen tonë, por ju ishit i pari dhe i vetmi që arritët t'i takoni gjashtë presidentë të Amerikës. I pari ishte Richard Nixon. Si u bë e mundur takimi juaj personalisht me të, çfarë biseduat dhe çfarë i kërkuat ju atij?*
**Ekrem Bardha:** Në atë periudhë junta e gjeneralëve grekë e sapoardhur në pushtet me grushtshtet, kishte filluar të bëhej një kërcënim i madh për Shqipërinë, ku nën thirrjet nacionaliste dhe shoviniste, kishte rishfaqur idenë e vjetër greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut për të ashtuquajturin Vorio Epir. Mbasi i takova dhe i shpjegova shqetësimin kongresistit Broomfield, i thashë se komuniteti shqiptar në Detroit është shumë i shqetësuar për rrezikun që i kanoset Shqipërisë nga Junta greke. Çfarë mund të bësh për këtë çështje jetike për atdheun tim? Ai më propozoi një takim me presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Richard Nixon, të cilit mund t'ia thosha drejtpërdrejt këtë shqetësim. Unë shtanga nga ky propozim i mikut tim.
Takimi u zhvillua në hotel "Hilton". Në takim isha unë, kongresisti Broomfield dhe presidenti Nixon. Kisha një emocion të papërshkruar, sepse unë pak vite kisha në Amerikë dhe po takoja njeriun më të fuqishëm të botës, presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Madje dhe anglishten nuk e kisha aq mirë.
Duke iu drejtuar presidentit Nixon, i thashë se kolonelët grekë kanë shfaqur hapur pretendimet e tyre për aneksimin e jugut të Shqipërisë, të cilin ata e konsiderojnë territorin e tyre, si të ashtuquajturin Vorio Epir. E pyeta çfarë mund të bëni zoti president që ta pengoni këtë veprim të juntës greke? Presidenti Nixon më tha: 'Kjo gjë nuk do të ndodhë! Unë nuk do të lejoj që pretendimet greke për territore të Shqipërisë të realizohen'. 'Qeverisë greke nuk do t'i jepet trajtim me përparësi, as nga pikëpamja territoriale, as në drejtim tjetër. Unë interesohem pa asnjë dallim për të gjithë amerikanët, pavarësisht origjinës së tyre kombëtare. Gjithashtu, kam interes të posaçëm për të gjithë popujt që jetojnë nën dhunën komuniste', më tha presidenti Nixon. Në një atmosferë shumë miqësore dhekonfidenciale, presidenti Nixon shkroi me dorën e tij këtë mesazh që unë e ruaj si një nga gjërat më të çmuara nga takimet e mia me presidentët e ShBA-së. Presidenti amerikan angazhohej të mos lejonte aneksimin e jugut të Shqipërisë nga kolonelët grekë. Unë i jam shumë mirënjohës kongresistit Broomfield i cili bëri të mundur realizimin e këtij takimi. Ky rast tregoi se Amerika ka qenë një mbështetëse e madhe e shqiptarëve dhe Shqipërisë edhe pse në atë kohë ishte nën sundimin komunist.
**(Vijon)**



Foto: Një kujtim më udhëheqësin dje politik të UÇK-së, sot president i shtetit më të ri të hartës së botës, Kosovës.
Nga e djathta z. Ekrem Bardha, presidenti Hashim Thaçi, Donika Bardha dhe Ferdinand Samarxhi

E rrallë

## Barazia gjinore, tani edhe me semaforë

Pas Hamburgut dhe Flensburgut edhe bashkia e qytetit Frankfurt mbi Main vendosi që shenjat e zakonshme të trafikut për këmbësorë të zëvendësohen në dhjetë semaforë të qytetit përgjithmonë me sinjale që tregojnë një çift homoseksual duke u përqafuar, ose një çift lesbikesh të kapura dorë për dore. Mbi ta shkëlqen edhe një zemër e vogël.



FOTO E DITES




Kjo fotografi tregon vullnetarët që renditin shishet plastike në një qendër riciklimi të drejtuar nga një organizatë budiste në Taipei. /AFP/

E jashtëzakonshme

## I humbet unaza në plazh, e gjen falë "Facebook"-ut




Kur Ann Busch dhe dy vajzat e saj Lola dhe Maisie filluan të bënin vrima në rërë për të ndërtuar kështjella, kurrë nuk do ta kishin imagjinuar gjetjen e një thesari të vërtetë: një unazë martese. Kjo ndodhi në Portsalon, në Irlandë. Ann mendoi se gjetja e të zotit/zonjës së saj do të ishte pothuajse e pamundur. Por, vendosi të provojë të kërkojë dhe të bëjë një apel në "Facebook", ku edhe u gjet pronari i unazës.

## BARSOLETA E DITËS



**E dashura: Shpirt, më duket vetja shumë e shëndoshë, e shëmtuar dhe e plakur. Të lutem, më bëj një kompliment.**
**I dashuri: Zemër, ke shikim shumë të mirë.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 16:00**

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird







**Në ora 18:20**

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

**Në ora 20:00**

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed






**Në ora 22:00**

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot duhet të bëni të pamundurën të mbyllni me sukses çdo iniciativë ose aktivitet që filloni.



**DEMI**
Gjatë ditës së sotme do të takoni shumë persona të rinj dhe do të ndikoheni mjaft pozitivisht prej tyre. Këto njohje do t'ju ndihmojnë në të ardhmen.



**BINJAKËT**
Meqenëse keni marrë shumë gjëra përsipër, sot jeni mjaft në tension që t'u dilni zot të gjithave. Nëse nuk do të arrini në ndihmë do t'ju vijnë familjarët.



**GAFORRJA**
Gjërat tuaja të vogla dhe personale mbase nuk janë në interesin e të gjithëve dhe nuk keni pse i bëni shumë publike. Merruni me çështje më madhore.



**LUANI**
Do të hasni në mjaft problematika sot gjatë ditës, por nëse nuk filloni t'i zgjidhni, do të mblidhen të gjitha në fund.



**VIRGJËRESHA**
Nëse jeni të interesuar për t'i shprehur dashurinë personit që keni në krah ose dikujt që sapo e keni njohur, sot është dita ideale për ta bërë.



**PESHORJA**
Duhet të punoni shumë që rezultatet të jenë ato që prisni në një projekt të caktuar. Duke qëndruar në pritje nuk do të arrini asgjë.



**AKREPI**
Nëse doni të ndiheni të lumtur këtë periudhë duhet të jeni më të pranishëm me familjarët tuaj për t'i rivendosur dialogët e ndërprera prej kohësh.



**SHIGJETARI**
Keni marrë vendime që kanë ndikuar shumë në karrierën tuaj dhe do të ndikojnë dhe në financat tuaja në të ardhmen.



**BRICJAPI**
Edhe pse po mundoheni shumë që të dukeni bukur karshi një personi të caktuar nuk do të bëjë ndonjë diferencë të madhe në jetën tuaj personale.



**UJORI**
Duhet t'u kushtoni më shumë vëmendje veprimeve tuaja sepse sot dikush po ju vëzhgon nga lart dhe nuk do t'i pëlqejë një sjellje e juaja.



**PESHQIT**
Duhet të jeni krenar për veten sepse po tentoni në të gjitha mënyrat të shpëtoni një raport që ka mjaft probleme që në fillim të tij.

# Leo Messi pushon në Ibiza



Pas eliminimit të Argjentinës në Kupën e Botës, Lionel Messi po shijon pushimet me familjen në Ibiza. Messi është parë duke shijuar diellin dhe detin, në një jaht në shoqërinë e bashkëshortes, fëmijëve dhe shokëve të ngushtë, në plazhet e ishullit spanjoll.

# Rita me poza seksi në Spanjë



Këngëtarja me famë botërore, Rita Ora, ka gjetur kohë për pak pushim. Ajo është duke qëndruar në Barcelonë të Spanjës, ku edhe ka ngritur temperaturat me dukjen e saj. Rita nuk ka hezituar të bëjë edhe disa poza seksi për të gjithë adhuruesit e saj.



# Një Emily verore

Ajo njihet për bukurinë e saj dhe për mënyrën se si di ta shfaqë atë secilën ditë në një mënyrë më ndryshe. Bëhet fjalë për modeluesen Emily Ratajkowski, e cila javën që lamë pas u pa duke shkuar për drekë në një restorant në Nju Jork City. 27-vjeçarja ishte veshur thjesht, por mahniti rrugët e Mollës së Madhe duke e zëvendësuar diellin pas perëndimit të tij.

# Ariana Grande e quan veten dhe të fejuarin "çift acarues"

Ariana Grande e ka quajtur veten dhe Pete Davidson "çift acarues", pas një postimi që ata e kanë bërë ku shihen duke u ledhatuar. Vetëm pse ajo dhe i fejuari i saj janë në "lulet" e dashurisë, kjo nuk do të thotë se këngëtarja nuk e kupton se sa shumë mund t'i shqetësojë të tjerët shfaqja e dashurisë së tyre në publik. "Zemra ime më do mua", ka shkruar 25-vjeçarja në "Instagram".



|  | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | IRNOSET (bised.) | CIGAN ENDACAK, ARIXHI | FABRIKAT E MEKANIZU-ARA | KRAHINË NË SHQIPËRI | SKUADËR | LLOJ VETURE JAPONEZE | | STADIUM I MADH NË BRAZIL | EMPOLI, GROSETO | NOTË MUZIKORE | BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA (shq.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | KRYETAR I NJË MANASTIRI TË MURGJVE ORTODOKSË | | | | | | | FUTBOLLISTI LIONEL .... | | | | |
| | | | | | | RRUSH KO-KËRRGJATË, I KUQ A I ZI DHE ME CIPË TË TRASHË | | | | | | | NIS TË ZBARDHË DITA / BEKIMI | | | | |
| | | | | | | E MBARUAR, E PËRFUNDUAR | | | | | | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / DREJTIM | | |
| | | | | | | NGJYRË E FYTYRËS | | | | PRIMITIV / AKTORJA AMERIKANE PORTMAN (shqip.) | | | | | | INTER / LLOJ BIME QË PËRDORET SI ERËZ PËR GJELLË | |
| | | | | | | | LOCAL AREA NETWORK / AKTORJA JONË IRENA | | | | SMIRË / KRIJIM, GJË E SHPIKUR NGA MENDJA | | | | | | RITUALET |
| | | | | | | BASHKËT. | | GOTË PREJ BAKRI / KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE | | | | HEROI ..... MEHA / FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART | | | | | |
| | | | | | | ALYSSA MILANO | | | PJESË E EPËRME E DHOMËS / SHARRËZ | | | | | | GABRIEL IGLESIAS / FUTBOLLISTI ARGJENTINAS HAVIER ..... | | |
| | PJESË E MEKANIKËS QË STUDION LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE | FAZA | KËNGËTARJA .... ZYMERI | ISH ATLETJA E SHQUAR MERLIN | NORA ISTREFI | FATKEQËSI E MADHE, KOB (shq.) | | | | | | | NITROGJEN / ZAKON | | | | |
| QENIE MBINJ-ERËZORE ME FUQI TË FSHEHTË (mit.) | | | | | | KËNGËTARJA NË FOTO ISMAILI | | | | | | | | NËNË (turq.) / ISMET TOTO | | | |
| PARA TË NËNTIT | | | | | | VLERËSIM ME NOTË / SHTET I MADH NË AMERIKËN VERIORE | | | | | | LETRARI MEHMETI / NGATËRRESA E MADHE | | | | TREVISO / BËRJE MË I RI | |
| SHEGA | | | | | SHTET I MADH NË AZI / KUNDREJT BASHKËTIN-GËLLORE | | | | | PA U NXITUAR, NGADALË (turq.) | I SHËMTUAR (bised.) / HARK, KTHESË | | | | | | BURG KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA |
| VËLLAI I MADH | | | | ZENEL AHMETI / VIJË E PËRKULUR SI LAK (gjeom.) | | | JETËSHKR-IMET / BABAI | | | | | | | "... TAK" / DASH QË E KA TURIRIN TË BARDHË E ME PIKLA SI TË KUQE | | | |
| MARK ANTONI | | | LUMË NË SHQIPËRI / KËNGËTARI SHAQIRI (shq.) | | | | | VEZAK | | | | | BALTË E QULLËT, GJANË (shq.) / TROPOJA | | | | |
| ZANORE | | FLEGËR / EMËR MASHKULLI TURK (shq.) | | | | | | I GJYMTI / DHËNIE E NJË ÇMIMI TË LARTË | | | | | | | "IZMIR" / KOPJIMET | | |
| RRËSHQANOR I MADH (zool.) | | | | | | | | | BASHKËT. / RRËMUJË | | JEMENI / DY BASHKË-TINGËLLORE | | HUMORIST I YNI / MUAJ I VITIT | | | | |
| BEND I YNI MUZIKOR | | | | | | | ALI ASLLANI / RAST | | | BANJË ALLATURKA / ENDE | | | | | | MOLDE / QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI | |
| | GËZIM I MADH / QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP | | | | | ISH FUTBOLLISTI FRANCEZ LILIAN ..... / VISHET ME BAR | | | | | | KËNGËTARJA ..... TAKE / AGJENCIONI EVROPIAN | | | | | |
| BANORE E LABËRISË | | | | | PRESIDENTI AMERIKAN OBAMA / KËNGËTARE E NJOHUR E SHQIPËRI | | | | | | ADEM JASHARI / RAMADAN AVDIU | | | HISTORIANI ROMAK LUKRECI / ARKË SHUMË E VOGËL PREJ DRURI | | | |
| KYÇI | | | | PRINCIPIELE / DJALI KUNDREJT PRINDËRVE (pashq.) | | | | | | | | | LLOJ PEME TROPIKALE (pashq.) / TENISTJA CLIJSTERS | | | | SHTEG |
| RIFAT ISMAJLI | | | ELEMENT KIMIK / BELGJIKA, AUSTRIA | | | | NËNË / "MESINA" | | | | | BIXHOZ / RENS ISTVUD | | | | | |
| ZANORE | | DY DUKURI QË KANË NDËRMJET TYRE LIDHJE TË DYANSHME / LECCE | | | | | | RESHAT ARBANA / TRIERI | | | KALORËS MESJETAR / BASHKËT. | | | | | | |
| VEGËL MUZIKORE | | | | | | | | | | KUFIZIM | | | | | | | |







# Sazani i Vlorës apo "Ishulli i luftës" i braktisur




Aty nuk gumëzhijnë më as nëndetëset, a katër-siluruesit, as ushtarët e marinarët shqiptarë dhe rusë… madje edhe anija e Zheleznovit ka ikur me kohë.

Porti, kazermat, qyteza, fortinot, tunelet dhe armët e rënda ia kanë lënë vendin heshtjes, ferrave, ndryshkësirave dhe braktisjes.

Ishulli dikur 'i papushtueshëm' i Sazanit, ose 'Porta e hekurt' e gjirit të Vlorës, sot lundron mbi valë si një anije e braktisur piratësh dhe mbi shpinë mban gjithë farë kujtimesh nga epoka e 'Luftës së Ftohtë'.

Një fotogaleri të rrallë shoqëruar me shpjegimet përkatëse, të gjithë asaj çfarë ka mbetur sot nga baza e dikurshme ushtarake e ishullit të Sazanit në Vlorë.

Tani prej disa kohësh ky ishull është hapur për turistët dhe kureshtarët e shumtë dhe për këtë anije të posaçme turistike nisen çdo mëngjes nga Porti Detar i Vlorës për të çuar aty vizitorët.

Por përveç objekteve të shumta ushtarake dhe ndonjë motovedete të Rojes Bregdetare, në ishull kanë mbetur vetëm kujtime të ndryshkura të asaj kohe që flet shumë me heshtjen e saj.

Megjithatë syrit të vëmendshëm të eksploruesve të apasionuar nuk u kanë shpëtuar tek-tuk edhe shumë objekte të flakura shkujdesur, apo të harruara ndër vite në ishull nga banorët e dikurshëm që jetonin dhe vigjilonin aty në 'mbrojtje' të socializmit.

Por sot armiku që nuk u shfaq asnjëherë si pushtues në brigjet e këtij ishulli-bazë, tani po vjen si turist dhe po gjallërron ishullin e braktisur që mbahet si një rrelike e kohës së 'Luftës së Ftohtë'.

*albania-arkiva.blogspot.com*

















# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | HOBRO - FC COPENHAGEN | 2 | CS UNIVERSITATEA - CSMS IASI | GG3+ | HAMMARBY - DALKURD | 1 |

# Historia interesante e Bardh Kelmendit në sport

Futbollisti Bardh Kelmendi ka një histori interesante në lojën e futbollit. Ai ka luajtur futboll për 13 vjet, kurse më pas vendosi për një pushim dyvjeçar dhe më pas është rikthyer në futbollin e vogël. Tash Kelmendi ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me skuadrën e Feniksit nga Drenasi dhe do të luajë në Ligën e Kampionëve



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 KORRIK - Bardh Kelmendi ka një histori interesante në fushën e sportit, konkretisht në lojën e futbollit. Ai karrierën e filloi në moshën 12-vjeçare në skuadrën e KEK-ut nga Kastrioti dhe me sukses të plotë kaloi të gjitha grupmoshat deri tek ekipi i parë. Kelmendi të dielën për "Epokën e re" ka rrëfyer për zhgënjimin e parë në lojën e futbollit kur kishte filluar të bëjë emër në ekipin e parë të KEK-ut. "Kam luajtur rreth 13 vjet nga gjeneratat e reja e deri në ekipin e parë, por kur fillova të ambientohem kushtet financiare nuk ishin të mira në klub dhe vendosa të pushoj dy vjet", ka thënë ai.

Bardh Kelmendi më pas ka treguar se pushimin nga sporti e shfrytëzoi maksimalisht në përgatitjen profesionale, përkatësisht duke vijuar studimet në Fakultetin e Mjekësisë. "Pas pushimit nga futbolli vendosa t'i kthehem Fakultetit të Mjekësisë në Degën e Fizioterapisë, ku arrita të diplomoj dhe të pajisem me licencë të Ministrisë", ka shtuar Kelmendi, i cili gjatë studimeve i hyri një tjetër "aventure" në sport, por këtë herë në futbollin e vogël. Ai që në provat e para i bindi drejtuesit e klubit të Prishtinës në futsall se ka cilësi. "Për dy sezone isha pjesë e Prishtinës, ku kemi arritur rezultate të mira dhe si rezultat i paraqitjeve të mira kam marrë disa oferta nga klubet e tjera", ka deklaruar ish-lojtari i KEK-ut.

Bardh Kelmendi tash ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me skuadrën e Feniksit me të cilën do të luajë në Ligën e Kampionëve dhe dëshira e tij është që së bashku me klubin nga Drenasi të paraqitet sa më mirë në këtë garë.

Niveli i futsallit në Kosovë është vazhdimisht në rritje, kurse Bardh Kelmendi ka shprehur mendimin se kjo lojë është shumë atraktive dhe vetëm për pak vite ka arritur ta rrisë nivelin në një shkallë mjaft të lartë. "Cilësia e fusallit është duke u rritur çdo herë e më shumë. Duke parë se kjo lojë në Kosovë i ka vetëm dhjetë vjet, atëherë të gjithë duhet të jemi të kënaqur me cilësinë. Loja e futsallit është mjaft atraktive si për lojtarët ashtu edhe shikuesit, pra kur isha pjesë e Prishtinës numri i shikuesve ka qenë i madh dhe kjo dëshmon më se miri se ditë të mira e presin këtë sport në Kosovë", ka përfunduar ai.

Skuadra ku do ta vazhdojë karrierën Bardh Kelmendi, Feniksi, deri te titulli i kampiones në Kosovë erdhi falë dy fitoreve ndaj Liburnit me rezultat 4-2 dhe 1-2.

# Papuqi: E dua Evropën me Gjilanin

Dalja në garat ndërkombëtare me skuadrën e Gjilanit e ka shtyrë mbrojtësin Fisnik Papuqi t'i refuzojë ofertat e tjera për të mbetur edhe një vit pjesë e kësaj skuadre. "Synimet e mia dhe të klubit janë të njëjta: dalja në garat ndërkombëtare. Pas largimeve të shumë futbollistëve, shtabi teknik dhe kryesia janë duke bërë një punë të jashtëzakonshme për krijimin e një skuadre shumë të fortë për edicionin e ri. Besoj se Gjilani do të jetë një skuadër shumë më e fortë se në kampionatin e kaluar", ka thënë Papuqi



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 KORRIK - Mbrojtësi me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Fisnik Papuqi, ka vazhduar edhe për një vit tjetër marrëveshjen me skuadrën e Gjilanit. Lajmin e ka konfirmuar vetë mbrojtësi pejan të dielën për "Epokën e re". "Kam pasur oferta interesante, por vendosa të vazhdoj me Gjilanin. Korrektësia e kryesisë dhe përvoja e mirë njëvjeçare me këtë klub më kanë shtyrë të mos ndryshoj skuadër", ka thënë fillimisht Papuqi.

Ishte pritur që mbrojtësi të rikthehet te Besa e Pejës, por ai vendosi të mbetet në skuadrën e Gjilanit me synimet e mëdha për daljen në garat ndërkombëtare. "Synimet e mia dhe të klubit janë të njëjta: dalja në garat ndërkombëtare. Pas largimeve të shumë futbollistëve shtabi teknik dhe kryesia janë duke bërë një punë të jashtëzakonshme për krijimin e një skuadre shumë të fortë për edicionin e ri. Besoj se Gjilani do të jetë një skuadër shumë më e fortë se në kampionatin e kaluar", ka thënë Papuqi.

Skuadra e Gjilanit në këtë afat kalimtar ka pësuar shumë ndryshime, ku disa nga lojtarët kryesorë janë larguar nga klubi. Mbrojtësit Armend Thaqi dhe Leotrim Bekteshi e kanë përforcuar Prishtinën, kurse ylli i sulmit, Betim Haxhimusa, iu bashkua rivales lokale, Dritës. Nga skuadra janë larguar edhe Diar Mustafa dhe disa lojtarë të tjerë. Mirëpo kryesia e klubit nuk ka qëndruar duarkryq dhe ka angazhuar fillimisht trajnerin me përvojë të madhe, Sadat Pajazitin, kurse më pas angazhoi edhe futbollistët: Vilfor Hysa, Jefferson Lopes, Ledjon Muçaj, Armend Halili, Ansi Nika, Brunild Pepa, Endrien Magani dhe Lucas Marcos Meireles. Gjilani në edicionin e fundit pati paraqitje të mira, por fati në disa raste nuk ishte në anën e tyre dhe ky klub kampionatin elitar e mbylli në pozitën e tetë me 46 pikë.

## Karaqi fiton medaljen e bronztë në Japoni



KOBE, 22 KORRIK - Alvin Karaqi ka fituar medaljen e bronztë në Kampionatin Botëror të Karatesë për Universitete, të mbajtur në Kobe të Japonisë. Karaqi e fitoi të bronztën përmes repesazhit, kategoria -84 kilogramë. Karateisti tjetër Elhami Shabani pësoi humbje në luftën për medaljen e bronztë përmes repesazhit. Me karateistët ishte edhe sekretari i Federatës së Karatesë së Kosovës, Nazi Gashi, që ishte në cilësinë e trajnerit. Kosova u përfaqësua nga Federata e Sportit Universitar të Kosovës, e cila është anëtare e plotë e Federatës Ndërkombëtare të Sporteve Universitare (FISU).

## Hamiltoni triumfon në Gjermani



Berlin, 22 korrik - Lewis Hamiltoni me Mercedesin fitoi garën e Çmimit të Madh të Gjermanisë në Formula 1, zhvilluar në pistën e Hockenheimit, duke bërë një paraqitje fantastike. Piloti britanik rikthehet në krye të renditjes botërore, shkëputur 17 pikë nga Vetteli, që gaboi me Ferrarin në pistën e shtëpisë dhe nuk e mbylli garën. Në podium u ngjitën edhe Valtteri Bottas me makinën Mercedes (i dyti) dhe Kimi Raikkoneni me Ferrarin (i treti). Për Hamiltonin ky është suksesi i katërt në garën e Gjermanisë.

# Formacioni më i shtrenjtë në histori të futbollit

Liverpool, 22 korrik - Portieri brazilian Becker Alisson, pas transferimit nga Roma në Liverpool është shndërruar në portierin më të shtrenjtë në histori të futbollit. Ai i ka kushtuar skuadrës angleze plot 73 milionë euro. Në formacionin më të shtrenjtë në histori të futbollit bën pjesë edhe një tjetër lojtar i Liverpoolit, Virgil van Dijk, i cili u transferua për 78.5 milionë euro nga Southamptoni. Tre mbrojtësit e tjerë në këtë formacion janë nga skuadra kampione e Anglisë, Manchester City. Benjamin Mendy i kushtoi Cityt 57.9 milionë euro për një transferim nga Monaco, kurse Aymeric Laporte nga Bilbao u transferua për 65.5 milionë euro. Pak më i lirë ishte Kyle Walker i Tottenham Hotspurit. Ky i fundit kushtoi 53.1 milionë euro. Në mesfushë është Paul Pogba i transferuar nga Juventusi në Manchester United për 105.2 milionë euro, kurse Philippe Coutinho nga Liverpooli i transferuar në janar te Barcelona kushtoi 125.9 milionë euro. Në mesfushë bën pjesë edhe lojtari i Bayern Munchenit, James Rodriguez, i cili i kushtoi Real Madridit 75.5 milionë euro për një transferim nga Monaco. Në fazën e sulmit janë Neymari me 223.7 milionë euro dhe Kylian Mbappe me 135 milionë euro, si dhe transferimi i shekullit në Itali, Cristiano Ronaldo. Juventusi pagoi 117.5 milionë euro për portugezin.




# Cousins: Erdha te Warriorsi për ta fituar titullin

Oakland, 22 korrik - Një javë më parë Golden State Warriors tronditi merkaton në ShBA duke nënshkruar me DeMarcus Cousins. Skuadra nga Oakland do të ketë një pesëshe titulluare, e gjitha e përbërë nga All Star. I vetmi pozicion ku kampionët në fuqi kishin probleme ishte ai i qendrës, por me ardhjen e 27-vjeçarit blindohet në të gjitha drejtimet skuadra e drejtuar nga Steve Kerr. Djaloshi nga Alabama, i cili sezonin e fundit ishte pjesë e New Orleans Pelicansit, u prezantua si afrimi më i rëndësishëm i Golden State dhe tregoi arsyet që e bënë ta pranonte ofertën e kalifornianëve. "Përpara se të firmosja më telefonuan të gjithë lojtarët e Warriorsit dhe më thanë: 'eja të fitojmë një tjetër titull!' Më bindi entuziazmi i tyre. Kanë fituar tituj, por janë ende të etur për trofe. Pashë tek ata motivim maksimal, sikur të mos kishin fituar asgjë, ndërkohë që janë kampionët në fuqi, kjo më bindi plotësisht të vija në Oakland". Cousins aktualisht po rikuperohet nga dëmtimi i rëndë që pësoi në janar. 27-vjeçari këputi tendinin e akilit dhe iu nënshtrua një ndërhyrjeje kirurgjikale. "Boggie" nuk la pa prekur edhe këtë temë, megjithëse nuk fiksoi një datë për rikthimin e tij në parket. "Rehabilitimi ka shkuar shumë mirë. Çdo ditë e ndiej veten më të fortë. Sa i përket datës së rikthimit, këtë nuk mund t'jua konfirmoj, por me kalimin e javëve do të ulemi me mjekun dhe trajnerin dhe do të përcaktojmë se kur do të jem në fushë", ka deklaruar ai.




## SHKURT

### Unitedi nuk e shet Martialin

Drejtuesit e Manchester Unitedit kanë ndërruar mendje në lidhje me Anthony Martial. Futbollisti francez nuk do të largohet nga "Old Trafford", i cili gati t'i ofrojë një kontratë të re. Skuadrat që kanë shfaqur interesim në këtë afat kalimtar për Martialin janë Chelsea, PSG-ja dhe Bayern Munchen.

### Rummenigge: Jamesi nuk rikthehet te Reali

James Rodriguez nuk do të rikthehet në Real Madrid këtë verë pavarësisht prej raportimeve të medieve. Lajmin e ka bërë me dije menaxheri i përgjithshëm i Bayern Munchenit, Karl Heinz Rummenigge. "Shumë thashetheme vijnë nga Spanja të cilat nuk janë të vërteta. Situata e kontratës së lojtarit është njohur mirë nga të gjithë. James patjetër do të luajë me ne këtë sezon dhe unë pres që ai të luajë për Bayernin përtej kësaj", ka thënë fillimisht Rummenigge.

### Neymar: Pas Botërorit nuk mund ta shihja me sy topin, e lëre më ndeshjet

Ylli i Brazilit ka pranuar se pas eliminimit nga Belgjika në çerekfinale nuk ka mundur ta shikojë me sy topin e as ndonjë ndeshje të futbollit. "Nuk doja të shkoja aq larg sa të them që nuk dua të luaj më futboll, por nuk doja të shikoja ndonjë top, ose t'i shikoj ndeshjet e mbetura të Botërorit", ka thënë Neymar. "Isha në zi, me të vërtetë isha tepër i mërzitur, mirëpo mërzia kalon. Unë e kam djalin tim, familjen, shokët dhe ata nuk duan të më shohin mua në gjendje të keqe. Kam më shumë arsye për të qenë i lumtur sesa i mërzitur".
Ai është pyetur për thashethemet që e lidhin atë me një kalim te Real Madridi. "Ata që i kanë shkruar këto lajme duket se e dinë jetën time më mirë sesa unë. Nuk dua që të përgjigjem në këto pyetje sepse asgjë nuk ka ndodhur". Po ashtu, Neymari e lavdëroi trajnerin e ri të PSG-së, Thomas Tuchel. "Ai është një trajner i madh dhe ne jemi duke shpresuar për një stinor të madh. Ne kemi nënshkruar me një legjendë të futbollit (portieri italian Gianluigi Bufffon), i cili do ta sjellë te ne gjithë përvojën e tij dhe kjo do të na ndihmojë shumë", ka deklaruar Neymar.

### Emery largon pesë yje nga Arsenali

Ardhja e Unay Emery në krye të Arsenalit pritet të sjellë ndryshime të mëdha. Trajneri spanjoll tashmë ka etiketuar pesë futbollistët e pavlefshëm për ekipin e tij në sezonin e ri, e që priten të largohen. Deri më tani dy lojtarë veç janë larguar. Bëhet fjalë për Jack Wilshere dhe Santi Carzola. Kësaj liste, sipas 'Sportskeeda', do t'i bashkohen edhe pesë futbollistë. Futbollistët që do të largohen janë: Danny Welbeck, Laurent Koscielny, David Ospina, Mohamed Elneny dhe Joel Cambell.

### Ozili sfidon Gjermaninë: Do ta bëja prapë foton me Erdoganin

